



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Hyrje në Gjuhësi

Ngarkesa: 4 ECTS, 30 orë leksione + 10 orë seminare

Viti / Semestri: Viti II/semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: “Bachelor në Gjuhë Frënge”

Kodi i Etikës: Kodi i Etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJE E LËNDËS DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objekti i përgjithshëm i lëndës: Qëllimi i kursit është të zhvillojë vetëdijen e studentëve për kompleksitetin e gjuhës dhe t'i bëjë ata të fitojnë një sërë aftësish teorike dhe metodologjike themelore për të kuptuar natyrën e thellë të fakteve gjuhësore të cilat ata do të jenë në gjendje t'i përdorin në të gjitha fushat e punës.

Objektivat specifike lëndore:

Studentët duhet të:

- 1.Kuptojnë nocionet që lidhen me shkencat gjuhësore;
- 2.Shpjegojnë perspektivat e ndryshme gjuhësore;
- 3.Njohin nocionet dhe konceptet themelore të shkencave gjuhësore;
- 4.Njohin natyrën, funksionet dhe ndërtimin e gjuhës;
- 5.Pajisen me konceptet themelore të disiplinave të gjuhësisë, kryesisht ato që lidhen me fushën e përkthimit.
- 6.Familjarizohen me nivelet e ndryshme të analizës gjuhësore.
- 7.Familjarizohen me praktikatat gjuhësore kontrastive